

VENDIM
Nr.716, datë 16.7.2008

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “PREZA TV”
SUBJEKTIT: “PREZA-TELEVISION” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 6.5.2008, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televisionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Preza –Televizion” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e komunës Prezë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)